



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2012

I DETYRUAR

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI A

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Gjimnazi: drejtimi natyror
(kurrikula e vjetër)

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**Kadare*****Mall***

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	B	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	D	1 pikë
Pyetja 7	C	1 pikë

Pyetja 8 (a) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Në këtë poezi sundon ngjyra **gri**: edhe pse nuk përmendet nga autori, shumë detaje ta sugjerojnë këtë ngjyrë: *vjeshta, qiejt e ngrysur pa lejlekë, shirat*. Mungojnë ylberet dhe sundon grija.
- Kjo ngjyrë sugjeron një trishtim pafund e të pashpjegueshëm për shpirtin poetik.

1 pikë Nëse tregon ngjyrën mbizotëruese të poezisë.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon nëntekstin që ajo mbart.

0 pikë Nëse përgjigja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 8 (b) 1 pikë**Model përgjigjeje**

- Fjala qelq krijon një efekt të menjëhershëm. Qelqi është diçka e brishtë, e thyeshme, e kthjellët me pika shiu mbi të, që janë po aq të kristalta. Në këtë mënyrë krijohet një lidhje me ndjenjën e mallit, po aq të brishtë dhe të pastër.

1 pikë Nëse shpjegon efektin që krijon fjala qelq në vargun e dhënë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 2 pikë**Arsyeja**

- Përdorimi i shumësit *qiej* rrit përmasat e trishtimit, që është i pafundmë dhe i pakuptueshëm për heroin lirik.

Imazhi

- Emri *qiej* në shumës krijon imazhin e një hapësire të pafundme për syrin njerëzor.

1 pikë Nëse tregon arsyen e përdorimit të shumësit.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon imazhin që përftohet nga ky përdorim.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 **1 pikë****Model përgjigjeje**

- Mungesa e ylberëve sugjeron praninë e grisë në poezi. Ata shihen dhe si mungesa e një ure lidhëse me vajzën, që ndodhet diku në anën tjetër të qytetit.

1 pikë Nëse interpreton nëntekstin e mungesës së ylberëve në poezi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 **2 pikë**

- Thënia e Heraklitit: “*Të zgjuarit janë bashkë në botë, / kurse të fjeturit janë veç*”, sugjeron se, **të zgjuarit** janë ata që e jetojnë jetën, që japin e marrin me njëri-tjetrin, kurse **të fjeturit**, ata që ëndërrojnë, humbasin shumë çaste të bukura, janë vetëm dhe s’ marrin kënaqësi nga jeta.

2 pikë Nëse shpjegon plotësisht thënien e Heraklitit.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon pjesërisht thënien e Heraklitit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 **1 pikë**

- Vargjet tingëllojnë paradoksale pasi ndjenja e mallit midis dy të rinjve nuk shkaktohet nga largësia, siç mund të ndodhë rëndom. Ata janë në një qytet, por shihen rallë.

1 pikë Nëse shpjegon paradoksin e vargut.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 (a) **2 pikë****Figura**

- simbol

Interpretimi

- **Vjeshta** është emblemë e gjendjeve shpirtërore nostalgjike, e kohëve të shkuara që s’kthehen më dhe e dashurive të humbura.

1 pikë Nëse zbulon figurën stilistikore.

DHE

1 pikë Nëse interpreton domethënien e vjeshtës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 (b) 2 pikë**Ndjesia**

- Një ndjenjë zbrastie e dëshpërimi, mungese.
- Vjeshtës i mungojnë në këtë poezi gjerat e bukura dhe piktoreske. Ndaj në imazhin e lexuesit krijohet vjeshta me mungesat e saj. (Interpretimi i lirë, por thelbi do të ruhet.)

2 pikë Nëse përcakton dhe shpjegon ndjesinë që i shkaktohet si lexues.

OSE

1 pikë Nëse vetëm e përcakton ndjesinë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Po ka një ndryshim. Vargu është: **Dhe** unë për ty seç ndjeva mall. Lidhëza **dhe** (shtuese) krijon idenë e përmbylljes së diçkaje.
- Tregon se mendimi është përmbyllur. Pra, gjithçka është e mbyllur për heroin, ka mbetur vetëm malli.

1 pikë Nëse tregon ndryshimin midis vargjeve.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon domethënien e këtij ndryshimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton se a i duket e natyrshme mungesa dhe malli për një dashuri që nuk është më;
- përdor argumente që mbështesin mendimin që ka;
- përdor ilustrime nga vepra ose filmi për të mbështetur shpjegimet e dhëna;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.

PJESA II**Heminguej*****Plaku dhe deti***

Pyetja 16	C	1 pikë
Pyetja 17	D	1 pikë
Pyetja 18	A	1 pikë
Pyetja 19	A	1 pikë
Pyetja 20	B	1 pikë
Pyetja 21	B	1 pikë

Pyetja 22 (a) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Djali shfaqet pak në novelë, por prania e tij është e rëndësishme pasi përkushtimi i tij ndaj plakut nxjerr më në pah vlerat e këtij të fundit si njeri dhe si peshkatar.
- Djali e shpreh hapur dashurinë që ka për Santiagon.

Pse është e rëndësishme prania e djalit?

- Djali përfaqëson jetën që do të vazhdojë pas vdekjes. Përkushtimi i tij për të mësuar nga përvoja e Santiagos, jep siguri se ky i fundit do të vazhdojë të jetojë përmes djalit.

1 pikë Nëse argumenton se cili është roli i djalit.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon pse është e rëndësishme prania e tij.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 (b) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Djali e demonstroi dashurinë e tij për Santiagon fare hapur. Ai do të sigurohet se plaku ka ushqim, ka veshje, ka rroba për t'u mbuluar dhe se do të pushojë pa e shqetësuar njeri.

Ilustrimet

- *i hodhi ca kafe në gotë*
- *Mos e shqetësojë njeri.*
- *Pije këtë*
- *Etj*

1 pikë Nëse tregon si e shfaq djali dashurinë për plakun.

DHE

1 pikë Nëse e mbështet mendimin me ilustrime nga fragmenti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 (c) 1 pikë**Model përgjigjeje**

- E thërret plak në shenjë respekti, dashurie. Si burim i një mençurie dhe përvoje, për të cilën djali ka nevojë. Por ndoshta e thërret edhe pse do që të duket paksa më i rritur dhe që e meriton të rrijë pranë Santiagos.

1 pikë Nëse shpjegon pse djali e thërret Santiagon *plak*.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 (a) 1 pikë

- Luanët janë simbol i forcës, i madhësisë, i bukurisë së natyrës. Ata sugjerojnë rrethin ciklik të jetës, por edhe harmoninë që ekziston midis forcave të ndryshme të natyrës.

1 pikë Nëse shpjegon nëntekstin e ëndrrës së Santiagos.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 (b) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Notat optimiste shfaqen në raportin që plaku ka me djalin, në përvojën që ai përçon tek ai, nga gjithçka e re që lind nga e vjetra.

OSE

- Santiago rilidhet me djalin, i cili kërkon medoemos të mësojë nga përvoja e plakut.

OSE

- Santiago nuk është vetëm, ai ka pranë dikë që e do dhe respekton. Të gjitha cilësitë fisnike të plakut dhe më të rëndësishmet, mësimet e nxjerra nga përvoja e gjatë jetësore, do t'i kalojnë djalit, që do të thotë se jeta e peshkatarit të vjetër do të vazhdojë, në disa forma, edhe pas vdekjes së tij.

OSE

- Edhe pse Santiago kthehet i mundur, ai nuk mposhtet nga peshku, por nga cikli i paevitueshëm i natyrës.

2 pikë Nëse identifikon dy momente ku shfaqen notat optimiste.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 3 pikë

- Përemrat kanë zëvendësuar fjalët (emrat) *peshkaqen dhe peshk*. Në asnjë moment plaku nuk ua përmend emrat.
- E lë të nënkuptohet.
- Parimi i ajsbergut.

1 pikë Nëse tregon se çfarë kanë zëvendësuar përemrat.

1 pikë Nëse shpjegon funksionin e këtij përdorimi.

1 pikë Nëse tregon tiparin e stilit që shfaqet.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Figurativisht po. Përmes djalit. Përvoja e tij do të kalojë te djali që e do dhe i është përkushtuar.

OSE

- Në të vërtetë, ndoshta jo. Ai thotë që diçka iu thye në gjoks. Beteja e jashtëzakonshme në det ka qenë shumë për moshën e tij.

Ilustrime

- *Por ne do të peshkojmë bashkë tani.*
- *sepse kam ende shumë gjëra për të mësuar dhe t'i mund të m'i mësosh të gjitha.*
- *ai qau përsëri.*
- *Etj.*

3 pikë Nëse argumenton plotësisht dhe me ilustrime mendimin.

OSE

2 pikë Nëse argumenton plotësisht mendimin, por nuk përdor ilustrime.

1 pikë Nëse argumenton pjesërisht, pa ilustrime mendimin.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
